

**OMNIX ALBANIA sh. p. k.**

**Pasqyrat Financiare Individuale  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022**

**OMNIX ALBANIA sh.p.k**  
**NIPT: K 81527005 D**  
**TIRANE**

Emërtimi dhe forma ligjore: **OMNIX ALBANIA SH.P.K.**  
NIPT (NUIS): **K81527005D**  
Adresa e selisë: **Gjiri i Lalzit, Komuna Draç, Durrës**  
Data e krijimit: **27.03.2008**  
Veprimtaria kryesore: Zhvillimi i pasurive te paluajtshme, investime ne infrastrukture, turizem, shitje me shumice dhe pakice dhe veprimtari te tjera te lidhura me te siperpermendurat. Botime, sherbime mediatike dhe publicitetet perfshi por pa u kufizuar ne botimin e revistave, gazetave, sherbime mediatike dhe sherbime te tjera shtese, aktivitet ne fushen e radios dhe televizionit. Punime ndertimi dhe zbatimimi perfshi por pa u kufizuar ne punime civile, urbanizim, instalim rrjeteve dhe kablllove. Import dhe eksport, eti.

## PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE PËR VITIN E MBYLLYR MË 31 DHJETOR 2022

Pasqyrat Financiare janë individuale:	Po
Pasqyrat Financiare janë të konsoliduara:	Jo
Pasqyrat Financiare janë të shprehura në:	Lekë
Pasqyrat Financiare janë të rrumbullakosura në:	Lekë
Periudha kontabël e Pasqyrave Financiare:	Nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022
Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare:	14/02/2024



OMNIX ALBANIA sh.p.k  
NIPT: K 81527005 D  
TIRANE

  
1

## Përmbajtja:

	<b>Faqe</b>
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2022	3
Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	4
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	5
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	6
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	7 - 16

OMNIX ALBANIA sh.p.k  
NIPT: K 81527005 D  
TIRANE

  
  
2

# OMNIX ALBANIA Sh. p. k.

## Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2022

(shumat në Lek)

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<b>Aktivet</b>			
<b>Aktivet afatshkurtra</b>			
Mjete monetare	4	3,173,650	1,884,397
Të drejta të arkëtueshme	5	63,733,558	57,917,312
Aktive të mbajtura për shitje	6	6,719,102	6,719,102
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>73,626,310</b>	<b>66,520,811</b>
<b>Aktivet afatgjata</b>			
Investime në shoqëri të kontrolluara	7	100	-
Aktive materiale	8	1,654,415,405	1,651,176,319
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>1,654,415,505</b>	<b>1,651,176,319</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>1,728,041,815</b>	<b>1,717,697,130</b>
<b>Detyrime dhe kapitali</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Detyrime afatshkurtra	9	9,902,935	5,790,822
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>9,902,935</b>	<b>5,790,822</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Detyrime afatgjata	10	229,945,372	217,781,949
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>229,945,372</b>	<b>217,781,949</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>239,848,307</b>	<b>223,572,771</b>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>			
Kapitali i nënshkruar	1	2,184,212,440	2,184,212,440
Fitimi (humbja) i pashpërndarë		(690,088,085)	(651,165,346)
Fitimi (humbja) e vitit		(5,930,847)	(38,922,735)
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>1,488,193,508</b>	<b>1,494,124,359</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>1,728,041,815</b>	<b>1,717,697,130</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 16 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 u aprovuan nga Bordi Drejtues i Omnix Albania Sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë më 16 shkurt 2024.

*SKENDER MADANI*  
Skender Madani  
Administrator

*Brunila Leskaj*  
Brunila Leskaj  
Kontabël i Miratuar  
HM&H Business Sh.p.k.

OMNIX ALBANIA sh.p.k  
NIPT: K 81527005 D  
TIRANE

HM&H BUSINESS Sh.p.k  
NUIS: L31615002K  
Rr. Abdi Toptani, Nd. Torre Drin, Kati 4  
Tiranë, Shqipëri

# OMNIX ALBANIA Sh. p. k.

## Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(shumat në Lek)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
<b>Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit:</b>			
Të ardhurat nga shitja	11	-	-
Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		-	-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		-	-
<b>Totali i të ardhurave nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>		-	-
<b>Shpenzimet:</b>			
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		-	-
Shpenzime të personelit:	12		
Paga dhe shpërblime		(3,499,646)	(3,579,799)
Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore		(512,879)	(438,078)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Amortizimi dhe shpenzime konsumi	8	(268,713)	(16,890,253)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	13	(6,020,700)	(19,132,028)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(37,305,010)</b>	<b>(40,496,446)</b>
<b>Të ardhura të tjera</b>		-	-
<b>Zhvlerësimi i aktiveve dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra</b>		-	-
<b>Të ardhurat dhe shpenzime financiare:</b>			
Të ardhura (shpenzime) nga interesat dhe të ngjashme, neto		-	-
Të ardhura (shpenzime) nga kursi i këmbimit, neto	14	4,371,091	1,117,423
<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare</b>		<b>4,371,091</b>	<b>1,117,423</b>
<b>Pjesa e fitimit (humbjes) nga pjesëmarrjet</b>		-	-
<b>Fitimi (humbja) para tatimit</b>		<b>(5,930,847)</b>	<b>(38,922,735)</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	15	-	-
<b>Fitimi (humbja) e vitit</b>		<b>(5,930,847)</b>	<b>(38,922,735)</b>
<b>Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>			
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:</b>			
Diferencat nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		-	-
Diferencat nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Diferencat nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje		-	-
Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet		-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>(5,930,847)</b>	<b>(38,922,735)</b>

Pasqyra e performancës dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 16 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

OMNIX ALBANIA sh.p.k  
NIPT: K 81527005 D  
TIRANE

# OMNIX ALBANIA Sh. p. k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2022

(shumat në Lek)

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva ligjore	Fitimet (humbjet) e pashpërndara	Totali
<b>pozicioni më 1 janar 2021</b>	<b>1,110,200,000</b>	-	(651,165,350)	<b>459,034,650</b>
Të ardhura (humbje) gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	(38,922,735)	(38,922,735)
Fitimi (humbja) e vitit	-	-	-	-
Të ardhura (humbje) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	(38,922,735)	(38,922,735)
<b>Të ardhura (humbje) totale gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(38,922,735)</b>	<b>-</b>
<b>Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:</b>				
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	1,074,012,440	-	-	1,074,012,440
Kapitalizim i fitimit pas tatimit	-	-	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>	<b>1,074,012,440</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1,074,012,440</b>
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2021</b>	<b>2,184,212,440</b>	-	(690,088,085)	<b>1,494,124,355</b>
<b>pozicioni më 1 janar 2022</b>	<b>2,184,212,440</b>	-	(690,088,085)	<b>1,494,124,355</b>
Të ardhura (humbje) gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	(5,930,847)	(5,930,847)
Fitimi (humbja) e vitit	-	-	-	-
Të ardhura (humbje) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	(5,930,847)	(5,930,847)
<b>Të ardhura (humbje) totale gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(5,930,847)</b>	<b>-</b>
<b>Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:</b>				
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	-	-	-	-
Kapitalizim i fitimit pas tatimit	-	-	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Pozicioni më 31 dhjetor 2022</b>	<b>2,184,212,440</b>	-	(696,018,932)	<b>1,488,193,508</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 16 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

OMNIX ALBANIA sh.p.k

NIPT: K 81527005 D

TIRANE

# OMNIX ALBANIA Sh. p. k.


## Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(shumat në Lek)

	Viti i mbyllur Shënime më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
<b>Fluksi monetar nga (përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit:</b>		
Fitimi (humbja) e vitit	5,930,847)	(38,922,735)
<i>Rregullime për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet financiare jomonetare	(4,393,411)	-
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin	-	-
Shpenzime amortizimi	268,713	401,184
Vlera neto kontabël e aktiveve të nxjerra nga përdorimi	-	15,187,303
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie (ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(5,584,081)	(3,993,023)
Rënie (Rritje) të gjendjes së inventarit	-	(5,417,336)
Rritje (rënie) në detyrimet e pagueshme	4,111,780	(3,915,261)
Pagesa për tatimin mbi fitimin	-	(241,774)
<b>Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit</b>	<b>(11,527,846)</b>	<b>(36,901,642)</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga (përdorur në) aktivitetin e investimit:</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(3,507,800)	3,219,100
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata jo materiale	-	-
<b>Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e investimit</b>	<b>(3,507,800)</b>	<b>3,219,100</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga (përdorur në) aktivitetin e financimit:</b>		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit	-	1,074,012,440
Arkëtime për financimet nga ortakët	18,463,576	-
Financime të dhëna për shoqëritë e kontrolluara	(1,942,521)	-
Kthime të financimeve nga ortakët	-	(1,041,876,988)
<b>Mjete monetare neto nga (përdorur në) veprimtaritë e financimit</b>	<b>16,521,055</b>	<b>32,135,452</b>
<b>Rritje (rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>1,485,409</b>	<b>(1,547,090)</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar</b>	<b>1,884,397</b>	<b>3,431,487</b>
<i>Efekti i luhatjeve të kurseve të këmbimit të mjeteve monetare</i>	<i>(196,156)</i>	<i>-</i>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	<b>4 3,173,650</b>	<b>1,884,397</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7–16 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

OMNIX ALBANIA sh.p.k  
NIPT: K 81527005 D  
TIRANE



6

# OMNIX ALBANIA Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 1. Informacion i përgjithshëm

Omnix Albania sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar më 23 mars 2008 dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB") më 27 mars 2008.

Fusha e aktivitetit të Shoqërisë konsiston në sa më poshtë:

- Zhvillimin e pasurive të paluajtshme, investime në infrastrukturë, turizëm, shitje me shumicë dhe pakicë dhe veprimtari të tjera të lidhura me të sipërpërmendurat;
- Botime, shërbime mediatike dhe publicitet, përfshirë por pa u kufizuar në botimin e revistave, gazetave, shërbime mediatike dhe shërbime të tjera shtese, aktivitet në fushën e radios dhe televizionit;
- Punime ndërtimi dhe zbatimimi përfshirë por pa u kufizuar në punime civile, urbanizim, instalim rrjeteve dhe kablllove;
- Import dhe eksport, eti.

Kapitali i nënshkruar i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2022 është 2,184,212,440 Lek (31 dhjetor 2021: 2,184,212,440 Lek).

Struktura e ortakëve të Shoqërisë si dhe gjendja e kapitalit më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë si më poshtë:

Ortaku	31 dhjetor 2022		31 dhjetor 2021	
	Vlera në Lekë	%	Vlera në Lekë	%
Jamal M Abuissa	655,263,732	30%	1,288,685,340	59%
Matrix Konstruksion	764,474,354	35%	546,053,110	25%
KLAR	436,842,488	20%	174,736,995	8%
RDA PETROL	327,631,866	15%	174,736,995	8%
<b>Totali</b>	<b>2,184,212,440</b>	<b>100%</b>	<b>2,184,212,440</b>	<b>100%</b>

	Kapitali i nënshkruar		Kapitali i nënshkruar i papaguar		Totali i kapitalit të nënshkruar të paguar	
<b>Kapitali i nënshkruar më 31 dhjetor 2020</b>	<b>1,110,200,000</b>		-		<b>1,110,200,000</b>	
Emetim i kapitalit	1,074,012,440		-		1,074,012,440	
<b>Kapitali i nënshkruar më 31 dhjetor 2021</b>	<b>2,184,212,440</b>		-		<b>2,184,212,440</b>	
Emetim i kapitalit	-		-		-	
<b>Kapitali i nënshkruar më 31 dhjetor 2022</b>	<b>2,184,212,440</b>		-		<b>2,184,212,440</b>	

Përfaqësues ligjorë të Shoqërisë gjatë vitit 2022 kanë qenë:

- Z. Jamal Abdulsalam M Abuissa deri më 29 mars 2022; dhe
- Z. Skender Madani me efekt nga data 29 mars 2022 dhe deri më 29 mars 2027.

NUIS i Shoqërisë është K81527005D dhe adresa kryesore e saj është në Gjiri i Lalzit, Komuna Draç, Durres.

Numri mesatar i punonjësve të Shoqërisë gjatë vitit 2022 është 2 (viti 2021 : 3).

### 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

#### 2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur duke respektuar parimin e vijueshmërisë, kërkesat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, të përmirësuara (SKK) të cilat janë të aplikueshme në mënyrë prospektive duke filluar nga data 1 janar 2019 si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 'Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare' i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2019.

#### 2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Bazat e matjes për çdo aktiv, detyrim, të ardhur dhe shpenzim janë përkrahur në detaje në shënimet shpjeguese në vijim.

#### 2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare**  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022*(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***2.4 Vlerësime dhe gjykime**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke pasur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

**2.5 Ndryshimet në politikat kontabël**

Si rezultat i NAS 13 Aktivitet Biologjike dhe Marrëveshjet e Koncesionit, i përmirësuar, Shoqëria ka ndryshuar politikën e saj kontabël në kontabilizimin e marrëveshjeve koncesionare për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015. Si rezultat i ndryshimit, Shoqëria ka njohur një aktiv jo-material marrë në këmbim të ndërtimit ose përmirësimit të një aktivi në një marrëveshje koncesionare, ndërsa më parë këto aktive ishin njohur si aktive afatgjata të materiale. Jeta e dobishme e pritshme e aktiveve dhe metodat e zhvlerësimit dhe amortizimit kanë ndryshuar siç përshkruhet në politikën kontabël 3.4.

**3. Politikat kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat të paraqitura në pasqyrat financiare.

**3.1 Transaksionet dhe balancat në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse

Zërat jomonetare të cilat përlogariten me kosto historike në monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kurset e këmbimit të datave të transaksionit fillestar. Zërat jomonetare të cilat njihen me vlerën e drejtë, në monedhë të huaj, konvertohen duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur përcaktohet vlera e drejtë. Humbja ose fitimi që rezulton nga konvertimi i zërave jomonetare trajtohet në të njëjtën mënyrë si njohja e humbjes ose fitimit nga ndryshimi i vlerës së drejtë të zërave të pasqyrës së pozicionit financiar (p.sh. diferencat e konvertimit në zëra të cilave u njihet humbja ose fitimi në pasqyrën e performancës).

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
1 EUR	114.23	120.76

**3.2 Instrumenta financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme. Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentet financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare njihen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me bankat si dhe investime të tjera afatshkurtra shumë likuide me maturim origjinal tre ose më pak muaj, të cilat janë objekt rreziku jo domethënës ndaj ndryshimeve në vlerë dhe që përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e detyrimeve të saj afatshkurtra.

### Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbriturhumbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

### Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e drejtë, pa përfshirë koston e transaksioneve.

### Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

### Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

### Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

## 3.3 Aktive afatgjata materiale

### (i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen me blerjen e aktivit si dhe kosto të tjera direkte që lidhen me sjelljen e aktivit në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në koston e aktivit nuk përfshihen koston e huamarrjes të cilat njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në të ardhura të tjera në pasqyrën e performancës.

### (ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

### (iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit, mbi jetën e dobishme të vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

Metodat e llogaritjes dhe përqindjet e amortizimit për secilën kategori aktivesh afatgjata për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si më poshtë:

Mobilje dhe pajisje zyre	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Të tjera pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%

### 3.4 Aktive afatgjata jo materiale

#### (i) Marrëveshjet e Koncesionit

Shoqëria njih një aktiv jo-material që rrjedh nga një marrëveshje koncesionare shërbimesh, kur ajo ka të drejtën për të shitur energjinë elektrike të prodhuar nga infrastruktura e koncesionit. Kjo nuk është një e drejtë e pakushtëzuar për të marrë para, pasi ajo është e varur nga sasia e energjisë elektrike së prodhuar nga hidrocentrali. Një aktiv jo-material marrë në këmbim të ndërtimit ose përmirësimit në një marrëveshje koncesionare shërbimi fillimisht matet me vlerën e drejtë duke iu referuar vlerës së drejtë të shërbimeve të ofruara.

#### (ii) Kostot vijuese

Pas njohjes fillestare, aktivi jo-material matet me koston, e cila përfshin kostot e kapitalizuara të huamarrjes, minus amortizimin dhe humbjet nga zhvlerësimi.

#### (iii) Amortizimi

Jeta e dobishme e pritshme e një aktivi jo-material në një marrëveshje koncesionare të shërbimeve është periudha nga momenti kur Shoqëria është në gjendje të përdorë infrastrukturën deri në fund të periudhës së koncesionit. Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën lineare dhe njihet në fitimet/(humbjet) e periudhës. Jeta e dobishme e vlerësuar e koncesionit më datë 31 dhjetor 2021 është 21 vjet.

### 3.5 Zhvlerësimi

#### (i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

#### (ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

### 3.6 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 3.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

### 3.8 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet llogarisë fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### 3.9 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin aktual të periudhës si dhe tatimin e shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen drejtpërdrejt në pasqyrën e performancës përveç rasteve kur këto lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Kompensimi midis aktiveve tatimore aktuale dhe detyrimeve tatimore aktuale ose midis aktiveve tatimore të shtyra dhe detyrimeve tatimore të shtyra kryhet vetëm nëse ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar këto shuma ose kur do të paguhet shuma neto e tyre apo do të realizohen aktivet dhe do të shlyhen detyrimet në të njëjtën kohë.

#### (i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është përlllogaritje e tatimit mbi fitimin të pagueshëm në lidhje me fitimin e tatueshëm të periudhës kontabël aktuale duke përdorur normën e tatimit në fuqi në datën e raportimit si dhe sistemimet në lidhje me tatimin e pagueshëm për periudha të shkuara.

Aktivitet dhe pasivitet tatimore përlllogariten në vlerën e pritshme që do të kompensohet ose do t'u paguhet autoriteteve tatimore. Për llogaritjen e vlerave u bëhet referencë normës tatimore dhe legjislacionit tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë në datën e raportimit. Fitimi i tatueshëm i periudhës ndryshon nga fitimi neto i paraqitur në pasqyrën e performancës si pasojë e rregullimeve në zërat e ardhurave ose shpenzimeve të cilat janë tatuar apo njohur si të zbritshme në periudha të tjera si dhe zërave të cilët nuk janë të tatueshëm apo të zbritshëm bazuar në legjislacionin tatimor në fuqi.

Drejtimi i shoqërisë në mënyre periodike vlerëson qëndrimet e mbajtura në përgatitjen e deklaratave tatimore për ato raste në të cilat parashikimet e legjislacionit tatimor në fuqi janë subjekt i interpretimeve nga ana e organeve tatimore shqiptare dhe krijon provizione aty ku është e përshtatshme.

#### (ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet si pasojë e diferencave të përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, humbjet tatimore dhe kreditimet tatimore të papërdorura, për aq sa ato ka mundësi të mbulohen nga përfitimet e ardhshme tatimore. Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri në masën që ka mundësi që të realizohet përfitimi tatimor. Aktivitet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në atë vlerë që do të jetë e mundur për të mbuluar aktivet tatimore të shtyra me fitimin e tatueshëm të viteve të ardhshme.

Aktivitet apo detyrimi tatimor i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme të lidhura me:

- njohjen e emrit të mirë;
- fitimet e papaguara nga investimet në filialet e huaja, degët, pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta në masën që investimi është i përhershëm i në kohëzgjatje përveçse kur është e dukshme që e dukshme që diferencat e përkohshme do të rimerren në të ardhmen e parashikueshme.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra përlllogariten sipas normës tatimore në fuqi në datën e raportimit.

# OMNIX ALBANIA Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 4. Mjetet monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Llogari rrjedhëse:		
Në Lek	1,374,247	1,734,753
Në Euro	1,436,517	83,408
Arka:		
Në Lek	362,886	66,236
<b>TOTALI</b>	<b>3,173,650</b>	<b>1,884,397</b>

### 5. Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Të arkëtueshme nga klientët	-	92,337
TVSH e arkëtueshme	57,559,495	56,038,271
Paradhënie për punonjës	5,948,226	1,560,533
Paradhënie për tatimin mbi fitimin	220,000	220,000
Paradhënie për furnitorë	5,837	6,171
<b>TOTALI</b>	<b>63,733,558</b>	<b>57,917,312</b>

### 6. Aktive të mbajtura për shitje

Aktivitet e mbajtura për shitje më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 në vlerën 6,719,102 konsistojnë në materiale dhe pajisje promovimi, pjesë e show-room të Shoqërisë, për të cilat Shoqëria do të ndjekë procedurat e shitjes në periudhën vijuese.

### 7. Investime në shoqëritë e kontrolluara

Investimet në shoqëri të kontrolluara më 31 dhjetor 2022 në vlerën 100 Lek përfshijnë koston e kapitalit të nënshkruar të shoqërisë Omnix Contracting and Engineering sh.p.k., zotëruar në masën 100% nga Omnix Albania Sh.p.k..



# OMNIX ALBANIA Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2022

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

8.

### Aktive afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë përbërë si më poshtë:

<u>Kosto</u>	<u>Toka</u>	<u>Pajisje informatike</u>	<u>Mobilje dhe orendi</u>	<u>Mjete transporti</u>	<u>Të tjera pajisje</u>	<u>Aktive në proces</u>	<u>Instalime teknike</u>	<u>Totali</u>
Më 31 dhjetor 2020	1,338,709,600	2,168,129	3,395,666	9,293,621	33,393,996	295,971,635	234,396	1,683,167,043
Shtesa	-	-	-	-	-	3,500,004	-	3,500,004
Pakësime	-	1,022,590	2,180,349	-	21,556,353	-	-	24,759,292
Më 31 dhjetor 2021	1,338,709,600	1,145,539	1,215,317	9,293,621	11,837,643	299,471,639	234,396	1,661,907,755
Shtesa	-	7,800	-	-	-	3,500,000	-	3,507,800
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2022	1,338,709,600	1,153,339	1,215,317	9,293,621	11,837,643	302,971,639	234,396	1,665,415,555
<u>Amortizimi i akumuluar</u>								
Më 31 dhjetor 2020	-	1,756,295	2,881,307	8,364,013	-	-	181,524	13,183,139
Amortizimi për vitin	-	102,959	101,729	185,922	-	-	10,574	401,184
Pakësime	-	986,231	1,866,655	-	-	-	-	2,852,886
Më 31 dhjetor 2021	-	873,023	1,116,381	8,549,935	-	-	192,098	10,731,437
Shtesa	-	31,458	-	-	-	-	-	31,458
Amortizimi për vitin	-	60,756	19,733	148,330	-	-	8,436	237,255
Më 31 dhjetor 2022	-	965,237	1,136,114	8,698,265	-	-	200,534	11,000,150
<u>Vlera e mbetur</u>								
Më 31 dhjetor 2020	1,338,709,600	411,834	514,359	929,608	33,393,996	295,971,635	52,872	1,669,983,904
Më 31 dhjetor 2021	1,338,709,600	272,516	98,936	743,686	11,837,643	299,471,639	42,298	1,651,176,318
Më 31 dhjetor 2022	1,338,709,600	188,102	79,203	595,356	11,837,643	302,971,639	33,862	1,654,415,405

OMNIX ALBANIA sh.p.k  
NIPT: K 81527005 D  
TIRANE

# OMNIX ALBANIA Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 9. Detyrime afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtra më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Të pagueshme ndaj furnitorëve	867,694	5,711,206
Të pagueshme ndaj punonjësve	4,766,837	-
Paradhënie nga të tretë	4,150,431	-
Të pagueshme për sigurime shoqërore dhe shëndetsore	79,475	45,540
Të pagueshme për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi	38,498	14,276
Të pagueshme për tatimin mbajtur në burim	-	19,800
<b>TOTALI</b>	<b>9,902,935</b>	<b>5,790,822</b>

### 10. Detyrime afatgjata

Detyrimet afatgjata më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 në vlerën 229,945,372 Lek dhe 217,781,949 Lek, respektivisht, konsistojnë në paradhënie nga ortakët për financimin e veprimtarive operacionale dhe investuese të Shoqërisë.

### 11. Të ardhurat nga shitja

Të ardhurat nga shitja për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë 0 Lek (zero).

### 12. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit përbëhen nga pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Paga dhe shpërblime	3,499,646	3,579,799
Shpenzime të sigurime shoqërore dhe shëndetësore	512,879	438,078
<b>TOTALI</b>	<b>4,012,525</b>	<b>4,017,877</b>

### 13. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime qiraje	353,594	1,296,334
Shpenzimi për energji elektrike dhe të ngjashme	920,453	244,072
Shpenzime mirëmbajtje	41,936	254,862
Shpenzime noteriale	781,119	-
Shpenzime për sigurime	80,910	87,737
Shpenzime për shërbime dhe konsulence teknike	125,000	123,000
Shpenzime sigurie	-	15,000
Shpenzime për gjopa dhe dëmshpërblime	249,588	121,206
Shpenzime për shërbime konsulence profesionale	2,162,057	12,127,885
Komisionet dhe shërbimet bankare	123,873	122,892
Taksa dhe tarifa vendore	476,020	112,100
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	159,574	348,883
Shpenzime zyre të ndryshme	226,789	710,461
Shpenzime transporti	-	112,430
Shpenzime mirëmbajtje për automjete	73,530	102,692
Shpenzime akomodimi	-	2,970,156
Tatime të tjera	130,950	4,000
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	-	218,415
Shpenzime jo korente	115,307	159,903
<b>TOTALI</b>	<b>7,174,637</b>	<b>10,396,885</b>

# OMNIX ALBANIA Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 14. Të ardhura (shpenzime) nga kursi i këmbimit, neto

Të ardhurat (shpenzimet) nga kursi i këmbimit, neto përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Fitime të realizuara nga kursi i këmbimit	36,004	1,145,784
Fitime të porealizuara nga kursi i këmbimit	4,594,893	-
	<b>4,630,897</b>	<b>1,145,784</b>
Humbje të realizuara nga kursi i këmbimit	(58,323)	(28,361)
Humbje të porealizuara nga kursi i këmbimit	(201,483)	-
	<b>(259,806)</b>	<b>(28,361)</b>
<b>TOTALI</b>	<b>4,371,091</b>	<b>1,117,423</b>

### 15. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2022 dhe 2021 është 0% për tatimpaguesit me qarkullim vjetor deri në 14 milionë Lek dhe 15% për tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi këtë shumë.

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

#### (i) Shpenzimi i tatimit mbi fitimin aktual

Për vitin 2021 dhe 2022 Shoqëria ka rezultuar me humbje kontabël dhe me humbje tatimore si më poshtë:

	2022	2021
Të ardhura	4,630,897	1,168,350
Shpenzimet	(10,561,743)	(40,091,085)
<b>Rezultati kontabël</b>	<b>(5,930,846)</b>	<b>(38,922,735)</b>
<i>Rregullime për diferenca të përkoshme:</i>		
Shpenzime të përlllogaritura	-	-
<b>Fitimi/(humbja) pas rregullimeve</b>	<b>(5,930,846)</b>	<b>(38,922,735)</b>

#### Shpenzime të panjohura:

Shpenzime postare dhe telekomunikimi	860	73,973
Shpenzime mirëmbajtjeje	5,350	91,938
Shpenzime zyre të ndryshme	224,489	329,038
Gjoha dhe dëmshpërblime	-	121,206
Shpenzime jo korrente	513,864	-
Shpenzime akomodimi	-	1,035,489
Mirëmbajtje dhe riparime automjete	58,530	70,710
Shpenzime transporti	-	72,430
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	-	218,415
Shpenzime celulare	18,308	5,762
Shpenzime kancelarie	9,630	14,960
Tatime të tjera	7,150	-
Nxjertje nga perdorimi AAGJ	-	15,187,303
<b>Totali i shpenzimeve të panjohura</b>	<b>838,181</b>	<b>17,221,223</b>

<b>Fitimi / (humbja) tatimore për periudhën</b>	<b>(5,092,665)</b>	<b>(21,701,512)</b>
Humbje tatimore të mbartura	(64,810,058)	(43,108,545)
Fshirje e humbjeve tatimore pa të drejtë mbartje	22,811,508	-
<b>Fitimi / (humbja) tatimore kumulative</b>	<b>(47,091,214)</b>	<b>(64,810,057)</b>

# OMNIX ALBANIA Sh. p. k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### Rikoncilimi i normës efektive të tatimit:

	2022	%	2021	%
Fitimi/(Humbja) e periudhës para tatimit	(5,930,847)	100%	(38,922,735)	100%
Fitimi/(Humbja) tatimore me shkallën tatimore standarde	(889,627)	15.00%	(5,838,410)	15.00%
<i>Shpenzime të panjohura:</i>				
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	129	0.00%	11,096	-0.03%
Shpenzime mirëmbajtjeje	802	-0.01%	13,791	-0.04%
Shpenzime zyre të ndryshme	33,673	-0.57%	49,356	-0.13%
Gjoha dhe dëmshpërblime	-	0.00%	18,181	-0.05%
Shpenzime jo korrente	77,079	-1.30%	-	0.00%
Shpenzime akomodimi	-	0.00%	155,323	-0.40%
Mirembajtje dhe riparime automjete	8,780	-0.15%	10,607	-0.03%
Shpenzime transporti	-	0.00%	10,864	-0.03%
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	-	0.00%	32,762	-0.08%
Shpenzime celulare	2,746	-0.05%	864	0.00%
Shpenzime kancelarie	1,445	-0.02%	2,244	-0.01%
Tatime te tjera	1,073	-0.02%	-	0.00%
Nxjerrje nga përdorimi AAGJ	-	0.00%	2,278,095	-5.85%
<b>TOTALI</b>	<b>(763,900)</b>	<b>12.88%</b>	<b>(3,255,227)</b>	<b>8.36%</b>

### (ii) E ardhura (shpenzimi) për tatimin e shtyrë

E ardhura (shpenzimi) për tatimin e shtyrë i njohur nga Shoqëria për vitet 2022 dhe 2021 është zero pasi nuk evidentohen diferenca materiale midis trajtimeve fiskale dhe kontabël për aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë.

### 16. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

### 17. Ngjarje të mëpasshme

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

